



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "International Security Association" Sh.P.K. të datës 02.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "International Security Association" Sh.P.K. të datës 02.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "International Security Association" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "International Security Association" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit** janë cituar si në vijim: *“ne kemi bere analizen financiare ku jane llogaritur te gjitha shpenzimet conform kerkesave te juaja, OE I shpallur fitues nuk mund te plotesoje te gjitha keto kushte si u tha me larte e ndoshta as pagat e caktuara te punetoreve per te cilen gje ne do ju japim nje shpjegim me kalkulim per te argumentuar pretendimin tone ankimor”*.

Lidhur me pretendimet ankimore duhet sqaruar se për parashtruesin nuk është kontestues fakti se tenderuesi i rekomanduar është i përgjegjshëm (pasi që nuk ka parashtruar argumente për të kundërtën). Njëkohësisht për parashtruesin nuk është kontestues as fakti se tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmimin më të lirë. Në anën tjetër kriteri i dhënies së tenderit është pikërisht çmimi më i lirë i tenderuesit të përgjegjshëm. Pra për parashtruesin nuk është kontestuese që tenderuesi i rekomanduar është i përgjegjshëm dhe ka ofertuar me çmimin më të lirë. Në fakt të gjitha pretendimet ankimore formulohen ashtu që çmimi i ofertuar është shumë i ulët. Mirëpo këto pretendime të formuluar në këtë mënyrë nuk i referohen as kërkesave të dosjes së tenderit dhe as dispozitave konkrete të LPP apo RRPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 06.10.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.